

VENDIM
Nr.904, datë 27.6.2008

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË DHE PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETEVE
PËRGJEGJËSE PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË FINANCIARE TË ZHVILLIMIT, SHA, DHE
LIKUIDIMIN E FONDACIONIT “FONDI I FINANCIMIT PËR ZONAT MALORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 54 të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr.8831, datë 22.11.2001 “Për pronësinë shtetërore, në shoqëritë tregtare, financiare, me kapital tërësisht shtetëror”, dhe të ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e strategjisë për shndërrimin e fondacionit “Fondi i financimit për zonat malore”, (FFZM), në Shoqërinë Financiare të Zhvillimit, sh.a., sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Vlera e kapitalit themeltar të Shoqërisë Financiare të Zhvillimit, sh.a., përbëhet nga fondet e renditura më poshtë, sipas pasqyrave financiare, të datës 31.12.2007 të fondacionit “Fondi i financimit për zonat malore”, të audituara nga një auditues i pavarur:
 - a) Fondet e dhëna grant nga qeveria shqiptare dhe/ose donatorë të ndryshëm.
 - b) Fondet e kapitalit fillestar të fondacionit, të përcaktuara në statusin e fondit, përfshi ato rezerva kapitali.
 - c) Fondet në zërin “Fitim i pashpërndarë”.
 3. Ministria e Financave, në cilësinë e përfaqësuesit të pronarit shtet, nënshkruan kapitalin themeltar të Shoqërisë Financiare të Zhvillimit, sh.a.
 4. Autorizohet bordi i drejtorëve të fondacionit “Fondi i financimit për zonat malore”, të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për krijimin e Shoqërisë Financiare të Zhvillimit, sh.a.
 5. Ministria e Financave, me cilësinë e përfaqësuesit të pronarit, mbikëqyr punën për hartimin e akteve të themelimit të shoqërisë dhe autorizon regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit e në institucionet e tjera të licencimit.
 6. Burimet njerëzore të strukturës ekzistuese, dhe pasuritë e fondacionit “Fondi i financimit për zonat malore”, i transferohen Shoqërisë Financiare të Zhvillimit, sh.a.
 7. Fondacioni, me regjistrimin e Shoqërisë Financiare të Zhvillimit, sh.a shpërndahet. Bordi i drejtorëve të fondacionit autorizohet të kryejë procedurat e likuidimit, në përputhje me statutin dhe ligjin nr.8788, datë 7.5.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”, si dhe të bëjë çregjistrimin e fondacionit në gjykatë.
 8. Vendimi nr.110, datë 25.2.2005 i Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa në vendimin nr.560, datë 2.12.1999 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e fondacionit “Fondi i financimit për zonat malore””, shfuqizohet.
 9. Ngarkohen Ministria e Financave dhe bordi i drejtorëve të fondacionit “Fondi i financimit për zonat malore” për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha